RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Kreshnik Spahiu:	10.05.2022	19.05.2022	132/22
Emri dhe Mbiemri i Ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 06.05.2022, Operatori Ekonomik (OE) "N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I) - Prishtinë ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), evidentuar me numër të lëndës 132/22, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e aktivitetit të prokurimit: "Krijimi i projektit për verifikimin e punimeve shkencore dhe validimin e thirrjeve akademike", me numër të prokurimit: 208 Udheheqesi-21-4951-2-2-1, iniciuar nga AK–Ministria e Arsimit.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00 €.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:
Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
- Neni 1 – paragrafi 1
- Neni 8 – paragrafi 1
- Neni 9 – paragrafi 1,2,3,4,5
- Neni 59 – paragrafi 1,4
- Neni 62 – paragrafi 1,2

Pretendimet ankimore
Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Ministria e Arsimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.

Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar në projektin në fjalë dhe jemi të përgjegjshëm, AK ka kryer shkelje duke mos i përmbushur dhe respektuar detyrimet si autoritet kontraktues sipas nenit 1 të LPP.

Neni 8 – paragrafi 1- Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 8 - Planifikimi i Prokurimit

1. Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ I Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:

1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;

1.2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokuroj gjatë vitit fiskal; dhe

1.3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Ministria e Arsimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 8.

Aktiviteti i prokurimit në fjalë ka qenë aktivitet nga viti 2021 i planifikuar në ligjin e buxhetit të vitit 2019. AK – Ministria e Arsimit ka qenë e informuar që kjo procedurë ka qenë në vlerësim nga data 18.08.2021. AK – Ministria e Arsimit ZKA, ZKF, është përgjegjësi e tyre që për aktivitetin në fjalë është dashur ta planifikojnë buxhetin për këtë aktivitet të prokurimit edhe për vitin 2022, pasi që AK – Ministria e Arsimit asnjë herë nuk ka nxjerrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit apo për ta shpërblyer me kontratë ndonjë OE i cili ka aplikuar në projekt. AK – Ministria e Arsimit ka qenë e obliguar që në

planifikimin e prokurimit për vitin 2022 ta përfshijë edhe këtë aktivitet të cilin tashmë kanë publikuar njoftimin për kontratë, kanë aplikuar OE dhe nga data e aplikimit deri me dt. 20.04.2022 ky aktivitet i prokurimit ka qenë në vlerësim nga AK. AK – Ministria e Arsimit është dashur domosdoshmërish që këtë aktivitet të prokurimit ta planifikojë edhe për vitin 2022.

Planifikimi i procedurave të prokurimit nuk është detyrim i OE, por është detyrim i Autoritetit Kontraktues, duke respektuar LPP.

Neni 9 – paragrafi 1,2,3,4,5 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 9 - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

1. Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikim in e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues.

2. Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.

3. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

4. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

5. Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve". Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshëmrinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1. të këtij neni, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstron se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2. të këtij neni, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga paragrafit 3. të këtij neni, për /pritjet e autoritetit kontraktues në lidhje me përvetësimet e ardhshme: dhe (iv) nëse është e aplikueshme, një deklaratë me shkrim që përshkruan masat që autoriteti kontraktues i ka marrë për t'u përputhur me paragrafin 4. të këtij neni. ZKA do të sigurojë që origjinali i nënshkruar i secilës Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të ruhet në dokumentacionin e autoritetit kontraktues dhe që një kopje ti dërgohet ZKF-së. Nëse ZKA vendos që autoriteti kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit, ZKA do ti dërgojë një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve Zyrtarit Autorizues dhe funksionarit më të lartë të autoritetit kontraktues (përveç rasteve kur ZKA është funksionari më i lartë i autoritetit kontraktues). KRPP do të përgatisë një formular standard të "Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" të cilin ZKA dhe ZKF e përdorin për përmbushjen e kërkesave të këtij neni.

6. Për autoritetet kontraktuese që janë autoritete publike ose ndërmarrje publike, nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues i cili është dorëzuar në AQP sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për inicimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. AQP -ja do të shqyrtojë çdo deklaratë të nevojave për të përcaktuar se nëse ka ndonjë metodë tjetër më efikase dhe më ekonomike për blerjen e mallrave të tilla ose produkteve të tjera, që i plotësojnë nevojat e autoritetit kontraktues. Në veçanti, nëse mallrat ose produktet përkatëse nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit që i është dorëzuar AQP -së sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji, AQP -ja do të shqyrtojë objektet e tilla për të identifikuar artikujt e përbashkët të prokurimit si dhe mallrat e tjera dhe artikujt që mund të sigurohen në mënyrë më efikase, përmes procedurës së përbashkët ose procedurës së zakonshme të prokurimit.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Ministria e Arsimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 9.

AK – Ministria e Arsimit ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me LPP dhe RROUP, dhe

se Vendimi mbi anulimin, dhe arsyetimi që AK – Ministria e Arsimit nuk ka mjete është vendim joligjor dhe i pabazuar në LPP.

Neni 59 – paragrafi 1,4 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Ministria e Arsimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 59.

Dhe se ne si OE NTSH UNISOFT jemi ofertë e përgjegjshme dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ne si OE pretendojmë që AK – Ministria e Arsimit nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK – Ministria e Arsimit dhe komisioni vlerësues janë përgjegjës individualisht për neglizhencën dhe zvarritjen e procesit të vlerësimit.

Neni 62 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – Ministria e Arsimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 62.

Arsye e anulimit të aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me këtë dispozitë pasi nuk plotësohen konditat dhe kushtet që një aktivitet i prokurimit të anulohet sipas LPP-së neni 62. Vendimi mbi anulimin i datës 20.04.2022 është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP dhe RROUP.

Faktet dhe argumentet shtesë nga vendimet e OSHP-së:

Vendimi i PSH-OSHP Nr. 151/20, 156/20, 166/20 dt. 07.04.2020

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim qëndron për faktin se hapja e ofertave është bërë me datën: 07.10.2019 dhe deri ne përfundim të vlerësimit te ofertave i cili është nënshkruar me datën: 04.02.2020, i bie qe vlerësimi ka zgjatur 117 dite dhe qe është në kundërshtim me dispozitat e nenit 41 te RrUOPP-se, dhe për të cilën eksperti shqyrtues nuk ka gjetur ndonjë sqarim nga ana e AK-se se pse ka zgjatur kaq shume vlerësimi i ofertave.

Sa i përket pretendimit të OE-ve, qe ka të bëje me anulimin këtij aktiviteti të prokurimit, eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se komisioni vlerësues, duke u mbështetur ne email-in e datës: 03.02.2020 e anulon këtë aktivitet te prokurimit. Email-i është dërguar tek AK-MAP, nga Kujtim Gashi – Drejtor i ASHI-se, i cili arsyetimin e tije deklaron se kanë qene te parapara 1,500,000.00 euro, nga 500,000.00 euro për secilin vite (2019,2020,2021), por pasi qe ka kaluar viti 2019, tani janë ne dispozicion vetëm 1,000,000.00 euro, ngase buxheti i vitit 2019, tanimë ka kaluar si i pa shfrytëzuar për shkak te procedurave ligjore të ankimimit.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se ne e-prokurim AK-ja, e ka ngarkuar deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmerise se fondeve, në të cilën ne piken II.1.3 është shënuar Vlera e parashikuar: 500,000.00 X 3 vite = 1,500,000.00.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se arsyet e dhëna nga ana e autoriteti kontraktues në deklaratën e datës 03.02.2020 nuk janë bindëse për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se nuk ka mjete të mjaftueshëm. Andaj, Paneli Shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bëre në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, andaj obligohet autoriteti kontraktues që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë konform nenit 59 të LPP-së, duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Vendimi i PSH-OSHP Nr. 224/21 dt. 30.03.2021

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Neni 8: Planifikimi i Prokurimit

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE BOTEK shpk mbi shkeljen nga AK – KK Fushë Kosovë rreth Neni 8: Planifikimi i Prokurimit sqaron se është përgjegjësi e AK që në përputhje me nenin 8 të LPP-së të planifikoj procedurat e prokurimit. Kjo procedurë është bartur nga viti i kaluar dhe në rastin e inicimit të projektit është nënshkruar disponueshmëria e mjeteve e cila është dashur të planifikohet edhe në vitin 2021.

1.Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ I Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:

1.1.në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;

1.2.në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokuroj gjatë vitit fiskal; dhe

1.3.në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.

2.Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Planifikimi i tillë përfundimtar duhet të përmbajë të dhënat që kërkohen nga sipas nën-paragrafit 1.1., 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1. të këtij neni.

3.AQP-ja menjëherë shqyrton dhe mbledh informacionet e dhëna në planifikimet e tilla. AQP-ja identifikon produktet e përdorimit të përbashkët dhe të gjitha artikujt dhe produktet e tjera që mund të sigurohen në mënyrë më efikase përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit.

Pretendimi i OE Botek lidhur me anulimin e aktivitetit në kundërshtim me Nenin 8 të LPP është i bazuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE BOTEK shpk mbi shkeljen nga AK të nenit 8 (Planifikimi i Prokurimit) të LPP-së, sqaron se është përgjegjësi e AK që në përputhje me nenin 8 të LPP-së të planifikoj procedurat e prokurimit. Kjo procedurë është bartur nga viti i kaluar dhe në rastin e inicimit të projektit është nënshkruar disponueshmëria e mjeteve e cila është dashur të planifikohet edhe në vitin 2021.

1. Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ I Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me

detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:

1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;

1.2.në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokuroj gjatë vitit fiskal; dhe

1.3.në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.

2.Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Planifikimi i tillë përfundimtar duhet të përmbajë të dhënat që kërkohen nga sipas nën-paragrafit 1.1., 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1. të këtij neni.

3.AQP-ja menjëherë shqyrton dhe mbledh informacionet e dhëna në planifikimet e tilla. AQP-ja identifikon produktet e përdorimit të përbashkët dhe të gjitha artikujt dhe produktet e tjera që mund të sigurohen në mënyrë më efikase përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit.

Andaj, pretendimi i OE "Botek" Sh.p.k. lidhur me anulimin e aktivitetit në kundërshtim me nenin 8 të LPP është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 7, nenin 8 dhe nenin 59 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se edhe anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të tenderëve të veproj në pajtim me dispozitat e LPP-së

Kërkojmë nga OSHP – Organi Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr:

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar Ankesa

II. ANULOHET Vendimi i datës 20.04.2022 i AK – Ministria e Arsimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

KRITERET PËR VLERËSIM

N/ A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I) - PRISHTINË

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 22.04.2022 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 28.04.2022 ka nxjerrë vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Përgjigje në pretendimin ankimor – OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur ta anulojë këtë aktivitet të prokurimit.
AK me datë 30.07.2021 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë dhe me datë 18.08.2021 është bërë hapja e ofertave. Sipas procesverbalit të hapjes, oferta kanë dorëzuar 4 (katër) OE, në mesin e tyre edhe OE ankues. Me datë 20.04.2022, AK ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin "*Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak se nuk kemi mjete te mjaftueshme për të vazhduar me tutje, Autoriteti kontraktues, ZKF nuk ka mundur te siguroj mjetet financiare për të krijuar njoftimin për dhenje të lëndës*".

Fillimisht, në e-prokurim nuk ka dëshmi se AK ka nënshkruar Deklaratën e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF, për inicimin e këtij aktiviteteti të prokurimit.
Më tej nuk ka dëshmi se AK pas hapjes se tenderëve ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve që do të duhej kryhet nga AK brenda përiudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë.
Duke marrë për bazë faktet e mësipërme, veprimet e AK-së janë në kundërshtim me LPP dhe RrOUPP nga inicimi e aktivitetit të prokurimit e deri tek përfundimi për arsyet si vijon.

a) AK është dashur që një projekt të tillë ta planifikojë dhe inicioj me kohë ashtu sikurse përcaktohet me Nenin 8 dhe 9 duke marrë për bazë edhe mundësitë e ankesave apo rrethanave tjera që parashihen me ligjin e prokurimit.
b) AK nuk ka dëshmi se pas hapjes së tenderëve ka filluar me ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve ashtu sikurse përcaktohet me nenin 41, paragrafi 2, i RRUOPP-së ku specifikohet: "*Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.*".
c) Në fund, arsyetimi i vendimit të AK për përfundimin e aktivitetit të prokurimit nuk është në përputhje me kushtet dhe rrethat që LPP i përcakton se kur duhet të përfundojë një aktivitet i prokurimit ashtu sikurse përcaktohet me Nenin 62 të LPP-së :

   1. *Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve".

Andaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara për faktin se veprimet e AK-së në këtë aktivitet nuk janë në pajtim me legjislacionin për prokurimin publik në Kosovë.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuara dhe të anulohet vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Arsimit
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I)